REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

Nr.1068 prot

Maliq , më 19/2/2026

PROJEK-VENDIM

Nr. 15 ,datë 19/02/2026

PËR

"MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRËNDSHME PËR PËRCAKTIMIN E STRUKTURAVE PËRGJEGJËSE DHE PROCEDURAVE PËR MATJEN DHE RAPORTIMIN E PERFORMANCËS NË BASHKI"

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, *"Për vetëqeverisjen vendore"*, neni 8, pika 2, neni 9 dhe neni 64 *"Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë"*; Ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996, *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"*; Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); Ligjit nr. 68/2017, *"Për financat e vetëqeverisjes vendore"* (i ndryshuar); Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* (i ndryshuar); Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018; Udhëzimit nr. 22, datë 13.07.2018; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 20.04.2023, *"Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030"*; si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 17, datë 20.02.2023.

VENDOS:

1. Të miratohet Rregullorja e Brendshme për përcaktimin e strukturave përgjegjëse dhe procedurave për matjen dhe raportimin e performancës në Bashki, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje, ngarkohen të gjithë strukturat drejtuese në bashki .
3. Pas miratimit kjo rregullore te publikohet në faqen zyrtare të bashkisë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Këshilli Bashkiak.

Konceptoi: J.Xhialli *Sekretare e Pergjithshme*

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

1068 19.276

RELACION

Për " Miratimin e Rregullores së Brendshme për përcaktimin e strukturave përgjegjëse dhe procedurave për matjen dhe raportimin e performancës në Bashki"

1. Qëllimi i projektvendimit

Ky projektvendim ka për qëllim miratimin e një rregulloreje të brendshme që përcakton strukturat përgjegjëse dhe procedurat e nevojshme për matjen dhe raportimin e performancës në Bashkinë Maliq. Rregullorja synon të krijojë një sistem të qartë, transparent dhe të standardizuar për monitorimin e punës së administratës vendore, duke rritur llogaridhënien dhe efikasitetin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

2. Baza ligjore

Projektvendimi mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil";
- Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë";
- Kodin e Procedurave Administrative;
- Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";
- Udhëzimet përkatëse të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 20.04.2023, mbi Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030;
- Urdhrin e Kryeministrit nr. 17, datë 20.02.2023.

Këto akte ligjore dhe nënligjore i japin bazë të plotë Bashkisë për të miratuar rregullore të brendshme që lidhen me menaxhimin e performancës.

3. Përmbajtja e rregullores

Rregullorja e brendshme e bashkëlidhur projektvendimit:

- Përcakton strukturat përgjegjëse brenda bashkisë për matjen e performancës;
- Vendos procedurat e raportimit periodik të rezultateve;
- Siguron transparencë dhe publikim të të dhënave në faqen zyrtare të bashkisë;
- Ngarkon drejtuesit e strukturave për zbatimin e saj.

4. Efektet e pritshme

- Rritja e efikasitetit të administratës vendore;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve;
- Forcimi i llogaridhënies dhe transparencës;
- Harmonizimi i praktikave të Bashkisë Maliq me strategjitë kombëtare për decentralizimin dhe qeverisjen vendore.

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e matjes dhe raportimit të performancës për funksionimin e mirë të administratës vendore, miratimi i kësaj rregulloreje është i domosdoshëm. Projektvendimi është në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjitë kombëtare, dhe rekomandohet miratimi i tij nga Këshilli Bashkiak.

Ju faleminderit !

Konceptoi : J.Xhialli *Sekretare e Pergjithshme*

KRYETARI I BASHKISË
Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ